



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 131

Prishtinë, më 3.12.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Boban Todorović, Salih Morina.

Mungoi : Liburn Aliu, Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 19.11.2013,
3. Shqyrtimi i Strategjisë për cilesinë e ajrit për vitin 2013/2022,
4. Shqyrtimi i monitorimit të Ligjeve në fushën e Komisionit,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.11.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19.11.2013.

3. Shqyrtimi i Strategjisë për cilësinë e ajrit për vitin 2013/2022.

Komisioni rekomandoj që të miratohet projekt Strategjia për cilësinë e ajrit për periudhën 2013-2022, ndërsa Plani i veprimit për vitin 2013-2017, i kthehet Qeverisë së Kosovës-Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim hapësinor, në ripunim, gjithashtu edhe për faktin se kjo pjesë është si dokument i veçantë sipas Ligjit për mbrojtjen e ajrit.

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet “Strategjia për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për vitin 2013-2017” me këto ndryshime, si vijon:

- Titulli i Strategjisë “Strategjia për cilësinë e ajrit për vitin 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për vitin 2013-2017” zëvendësohet me “Strategjia e cilësisë së ajrit për periudhën 2013-2022”;
- Në tërë tekstin e dokumentit fshihet fjalia “Plani i Veprimit” si dhe pikat: 13.0, 13.1, 13.2, 13.3, 13.4, 13.5, 13.6, 14.0 (nga faqja 57 – 60); 10.1.1 (në faqen 67); 10.2.1 (në faqen 71); 10.4.1 (në faqen 84) dhe tabela 10.5 (në faqen 85).

4. Shqyrtimi i monitorimit të Ligjeve në fushën e Komisionit.

Në këtë pikë Komisioni shqyrtoj planin e monitorimit të zbatimit të ligjeve. Komisioni do të filloj monitorimin i zbatimit të **Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga ndotja dhe Ligjin për Vererat, ndërsa** nuk do të monitoroj **Ligjin për Pyjet dhe Ligjin për Zhurmen** se pritet që këto ligje të vinë si projektligje të reja në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 12,15.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani